



EDUKIMI MJEDISOR



Shkurt 2025

Edukimi mjedisor i ndihmon nxënësit të njihen me çështje të rëndësishme dhe jetike si: ujin, ajrin, tokën, natyrën, biodiversitetin. Ai është veprimtaria akademike dhe praktike, që përfshinë studimin sistematik të mjedisit dhe gjithë marrëdhënieve që e shoqërojnë; përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Përgjatë tyre nxënësit përfshihen emocionalisht dhe fizikisht; ata mësojnë për zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave të ndotjes, mbetjeve, energjisë, ekonomisë qarkulluese. Nxënësit përfshihen në mbrojtjen e natyrës dhe njëkohësisht e duan edhe më shumë atë.

"Ndryshimi vjen nga veprimet e vogla të çdo qytetari. Ato bëjnë diferencën.

Për mua, një veprim i vogël është mbjellja e pemëve."

Wangari Maathai

Mentorët e tyre, të cilët janë specialistët e edukimit mjedisor në të 12 AdZM-të e vendit mbështesin, përfshijnë dhe ndërmarrin nisma të përbashkëta me nxënësit, për përmirësimin e mjediseve të ndryshme. Në sajë të këtyre veprimtarive ata zhvillojnë shprehje dhe dije mjedisore, që i bëjnë të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme e të mençur. Përmes edukimit mjedisor nxënësit e niveleve të ndryshme akademike përfitojnë:

vetëdije dhe ndërgjegjësim për mjedisin dhe sfidat mjedisore

kuptojnë dhe analizojnë probleme dhe çështje shqetësuese mjedisore

motivohen dhe përfshihen për përmirësimin e cilësisë së mjedisit në nivel lokal dhe kombëtar

ndërmarrin nisma dhe veprimtari që synojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit



Përmes këtij manuali mujor **Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura** paraqet aktivitetet e zhvilluara nga **12 Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura**, me nxënësit e shkollave të ndryshme në mbarë vendin dhe atyre që ndodhen pranë ZM-ve apo në zonat rurale, përgjatë muajit **shkurt 2025**. Aktivitetet janë zhvilluar në kuadër të ditëve mjedisore, promovimit të zonave të mbrojtura, lojërave të ndryshme edukative dhe argëtuese në mjediset e shkollave apo në natyrë, duke synuar gjithëpërfshirjen e nxënësve të të dy gjinive, niveleve të ndryshme ekonomike dhe vendndodhjen gjeografike.

Nxënës të përfshirë **651**

Specialistë të angazhuar **22**

Orë mjedisore të realizuara **34**

31 Shkolla të përfshira

37 Mësues të përfshirë

3 Universitete të përfshira

“EDUKIMI MJEDISOR”, SHKODËR



2 shkurt 2025, Dita Botërore e Ligatinave

Në kuadër të Ditës Botërore të Ligatinave, nxënësit e shkollës “Natyralistët” morën pjesë në një aksion pyllëzimi të zhvilluar në Malin e Munellës pjesë e zonës së mbrojtur Parku Natyror Munellë. Ky aksion u organizua nga specialistët e AdZM Shkodër, në bashkëpunim me organizatën PPNEA, Well Point, vullnetarë dhe partnerë të tjerë mjedisorë. Gjatë këtij aksioni u mbollën 1300 fidanë pishe e egër, duke kontribuar në përmirësimin e gjendjes së pyjeve dhe forcimin e mbrojtjes së biodiversitetit. Përfshirja e nxënësve në këtë nismë shërbeu si një shembull i edukimit mjedisor në praktikë dhe rritjes së ndërgjegjësimit për rëndësinë e ekosistemeve pyjore dhe ligatinave.

3 shkurt 2025, mbrojtja e ekosistemeve

Dita Botërore e Ligatinave është një ngjarje ndërkombëtare që ka për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e ligatinave dhe mbrojtjen e këtyre ekosistemeve të veçanta. Specialistët e AdZM Shkodër realizuan një orë mjedisore në kuadër të kësaj dite, me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Gjergj Vat Martini”. Gjatë kësaj ore, ata diskutuan mbi rolin dhe rëndësinë e ligatinave në ruajtjen e biodiversitetit dhe ekosistemeve natyrore. Nxënësit u njohën me disa nga ligatinat më të rëndësishme në rajon, si Liqeni i Shkodrës, Lumi Buna - Velipojë, si dhe me territoret ligatinore përreth këtyre zonave. Mesazhi kryesor i përcjellë ishte rëndësia e njohjes dhe ruajtjes së këtyre ekosistemeve natyrore për të siguruar një mjedis të shëndetshëm.

19 shkurt 2025, orë mjedisore

Orët mjedisore janë shumë të rëndësishme për rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimin e nxënësve mbi mbrojtjen e mjedisit dhe rëndësinë e ruajtjes së natyrës. Ato ndihmojnë në krijimin e një kulture mjedisore tek të rinjtë, duke i inkurajuar ata të jenë pjesë aktive në ruajtjen e burimeve natyrore. Në kuadër të Edukimit Mjedisor, specialistët e AdZM Shkodër zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës së mesme të Bashkuar “Lucë Agraja”. Gjatë kësaj ore, nxënësit u informuan mbi zonat e mbrojtura dhe rolin e tyre të rëndësishëm në jetën e përditshme të komunitetit dhe zhvillimin e turizmit. Përveç informacionit teorik, u zhvillua edhe një aktivitet sensibilizues pastrimi, ku nxënësit morën pjesë aktivisht.



ligatinat

aksion pyllëzimi

edukim mjedisor

“EDUKIMI MJEDISOR”, KUKËS



ditë botërore

ligatina

park kombëtar

ndërgjegjësim

4 shkurt 2025, Dita Botërore e Ligatinave

Në kuadër të Ditës Botërore të Ligatinave, specialistët e AdZM Kukës zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Krumë”. Gjatë kësaj ore, nxënësit u njohën me ligatinat në Shqipëri, ku mësuan për rolin dhe rëndësinë e tyre, si dhe ndikimin që ato kanë në biodiversitet dhe zhvillimin e turizmit në këtë zonë. Ligatinat në Shqipëri janë shumë të vlefshme, pasi ofrojnë habitat për shumë specie të florës dhe faunës, përfshirë disa lloje të rrezikuara. Mesazhi i përçuar ishte ndërgjegjësimi i nxënësve për vlerat dhe rëndësinë e ligatinave në ruajtjen e natyrës dhe ekosistemeve të saj.


10 shkurt 2025, Alpet Shqiptare

Në kuadër të edukimit mjedisor, në ambientet e shkollës 9-vjeçare “Besëlidhja e Malsisë”, Tropojë, specialistët e AdZM Kukës zhvilluan një orë mjedisore me temë “Rritja e interesit të komunitetit në mbrojtjen e vlerave të Parkut Kombëtar të “Alpeve Shqiptare”. Gjatë këtij aktiviteti, nxënësit u njohën me rëndësinë dhe pasuritë natyrore që ky park ofron, si dhe rolin e tij të pazëvendësueshëm në ruajtjen e biodiversitetit dhe pasurimin e ekosistemit. U theksua rëndësia e angazhimit të komunitetit në mbrojtjen e këtyre vlerave për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm, duke ruajtur burimet natyrore për brezat e ardhshëm.

18 shkurt 2025, Parku Kombëtar Korab-Koritnik

Specialistët e AdZM Kukës zhvilluan një orë mjedisore në shkollën 9-vjeçare “Isuf Seferi” Fshat, ku nxënësit u njohën me atraksionet turistike të Parkut Kombëtar Korab-Koritnik, me qëllim mbrojtjen dhe promovimin e tyre. Gjatë aktivitetit, u theksua rëndësia e ruajtjes dhe promovimit të këtyre pasurive natyrore, duke i ndihmuar nxënësit të kuptojnë si mbrojtja e natyrës mund të kontribuojë në ruajtjen e biodiversitetit. U shpjegua gjithashtu se si nxënësit mund të kontribuojnë në ruajtjen e këtyre pasurive përmes veprimeve të thjeshta, si pastrimi i zonave mjedisore, shmangia e hedhjes së mbetjesh dhe ndjekja e rregullave për ruajtjen e mjedisit, duke bërë kështu një ndryshim pozitiv në ruajtjen e natyrës.





2 shkurt 2025, Dita Botërore e Ligatinave

Në kuadër të Ditës Botërore të Ligatinave, specialistët e AdZM Dibër zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës “Selim Alliu”. Gjatë aktivitetit, nxënësit u njohën me rëndësinë e ligatinave si ekosisteme të veçanta që ofrojnë habitate për një gamë të gjerë gjallesash, përfshirë shpendët, amfibët, peshqit dhe shumë specie të tjera. Ligatinat janë shumë të rëndësishme për ruajtjen e biodiversitetit, pasi veprojnë si zona inkubimi për shumë lloje të kafshëve dhe bimëve. Përmes aktiviteteve interaktive, nxënësit mësuuan se si këto ekosisteme ndihmojnë në pasurimin e natyrës dhe si mund të kontribuojnë ata në mbrojtjen e ligatinave, duke ruajtur ekosistemet dhe pasuritë natyrore që ato ofrojnë.

27 shkurt 2025, orë mjedisore

Administrata e Zonave të Mbrojtura në Dibër, realizoi një orë mjedisore me nxënësit e shkollës “Papa Gjon Pali II” në Ulëz. Gjatë aktivitetit, nxënësit u informuan nga specialistët rreth vlerave të jashtëzakonshme të Parkut Natyror “Liçeni i Ulzës”, duke theksuar rëndësinë e tij për biodiversitetin dhe ruajtjen e ekosistemit. Dita Botërore e Ligatinave ofron një mundësi për të mësuar më shumë për këto ekosisteme jetësore dhe për të zhvilluar një lidhje më të fortë me natyrën si dhe për të kuptuar përpjekjet që bëhen për mbrojtjen e tyre.

“EDUKIMI MJEDISOR”, LEZHË

04 10 18



edukim mjedisor

ditë botërore

rëndësia e ligatinave

flamingo

4 shkurt 2025, orë mjedisore

Specialistët e AdZM Lezhë zhvilluan një aktivitet mjedisor me nxënësit e klasës V të shkollës 9-vjeçare “Nikë Tomë Prela” në Gorre. Aktiviteti u zhvillua nën moton “Ruajmë ligatinat, ndërtojmë të ardhmen! Vlerëso, Mbro, Frymëzohu!”. Nxënësit u njohën me konceptin e ligatinave dhe rëndësinë e tyre për biodiversitetin, duke mësuar për gjallesat që jetojnë në to. Aktivitete të tilla synojnë edukimin e nxënësve për rëndësinë e ligatinave dhe nxitjen e përgjegjshmërisë së tyre në mbrojtjen e mjedisit.

12 shkurt 2025, orë mjedisore

Specialistët e AdZM Lezhë organizuan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Kolec Mekshaj”. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte krijimi i planetit Tokë ku nxënësit shpërndanë mesazhe sensibilizuese që theksuan rëndësinë e ruajtjes së natyrës. Gjatë aktivitetit, nxënësit përdorën krijimtarinë e tyre për të nxitur ndërgjegjësimin mbi mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e burimeve natyrore. Ky aktivitet i inkurajoi nxënësit të shpreheshin dhe të diskutonin ide me njëri-tjetrin, duke u fokusuar në mënyrat për të përmirësuar mjedisin dhe për të ruajtur planetin nga dëmet e shkaktuara nga aktivitetet njerëzore.

18 shkurt 2025, pema e mesazheve

Në shkollën e mesme “Karl Gega”, specialistët e AdZM në Lezhë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit. Aktiviteti u përqendrua në njohjen e shpendëve që banojnë në zonat ligatinore dhe në rolin e tyre të rëndësishëm për ekosistemet natyrore. Nxënësit mësuan për disa lloje shpendësh, përfshirë flamingot, të cilët janë të njohur për pendët e tyre rozë dhe këmbët e gjata. Flamingot janë gjithashtu një pjesë e rëndësishme e faunës shqiptare, duke populluar laguna dhe zona të mbrojtura në vendin tonë. Pas kësaj, ata krijuan modele flamingosh me materiale të riciklueshme, duke shfaqur kreativitetin e tyre dhe duke kontribuar në promovimin e riciklimit.



“EDUKIMI MJEDISOR”, DURRËS



4 shkurt 2025, Dita Botërore e Ligatinave

Specialistët e AdZM Durrës, në kuadër të Ditës Botërore të Ligatinave, zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Myrteza Pengili” në Krujë. Qëllimi i kësaj ore mjedisore ishte informimi i nxënësve mbi rëndësinë e ligatinave për mjedisin dhe njeriun. Gjatë kësaj ore, ata diskutuan për rolin e ligatinave në ruajtjen e biodiversitetit, pastrimin e ujërave, parandalimin e përmytjeve dhe mbështetje për shumë lloje të florës dhe faunës. Nxënësit mësuan gjithashtu për ligatinat që ndodhen në Shqipëri dhe rëndësinë e ruajtjes së këtyre ekosistemeve të veçanta.

5 shkurt 2025, ligatinat në Shqipëri

Në Ditën Botërore të Ligatinave, u organizua një aktivitet informues dhe edukativ në shkollën e mesme të Bashkuar “Jusuf Hoti” në Durrës, në bashkëpunim me PPNEA dhe specialistët e AdZM Durrës. Aktiviteti kishte për qëllim të informonte nxënësit për rëndësinë e ligatinave, duke përdorur pamje vizuale dhe postera informues. Nxënësit mësuan rreth rolit të rëndësishëm që këto ekosisteme luajnë në ruajtjen e biodiversitetit dhe balancën e natyrorës. Aktiviteti synoi rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e ligatinave, të cilat kontribuojnë në një mjedis të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm.

13 shkurt 2025, Parku Natyror Qafështamë

Nxënësit e shkollës "Albanian College Tirana" vizituan Parkun Natyror të Qafështamës, ku, nën kujdesin e specialistëve të AdZM Durrës, ata u njohën me vlerat natyrore dhe biodiversitetin e kësaj zone të mrekullueshme. Aktiviteti, që u zhvillua në territorin e Parkut Natyror Qafështamë, përfshiu një sesion informues për nxënësit, të cilët mësuan rreth rëndësisë ekologjike të kësaj zone. Mesazhi i përcjellë tek nxënësit ishte mbi përvojat direkte në natyrë, të cilat ndihmojnë në forcimin e lidhjes emocionale me mjedisin dhe rrisin motivimin për ta mbrojtur atë.

20 shkurt 2025, Dita e Shërbimit Pyjor

Specialistët e AdZM Durrës, në kuadër të edukimit mjedisor, organizuan një aktivitet me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Perlat". Gjatë këtij aktiviteti, ata mësuan se si mund të kontribuojnë për një mjedis më të shëndetshëm, duke u fokusuar në veprime si reduktimi i ndotjes, mbjellja dhe mbrojtja e pemëve, kursimi i energjisë dhe ujit dhe përdorimi i transportit ekologjik. Në fund të aktivitetit, nxënësit mbollën 50 fidanë pishë të butë rreth shkollës, duke kontribuar në ruajtjen e natyrës dhe promovimin e një mjedisi të pastër.



2 shkurt 2025, njohja me ligatinat

Në kuadër të Dites Botërore të Ligatinave, nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Vilë Bashtovë" pjesë e Parkut Kombëtar "Divjak-Karavasta, morën pjesë në një aktivitet informues të organizuar nga specialistët e AdZM Tiranë. Gjatë këtij aktiviteti, ata u njohën me rëndësinë e ligatinave si habitate natyrore të pasura me florë dhe faunë të veçantë. Aktiviteti kishte si qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të nxënësve për ruajtjen e këtyre ekosistemeve të çmuara dhe rolin e tyre të rëndësishëm në mbështetje të biodiversitetit dhe shëndetit të mjedisit.

11 shkurt 2025, Rëndësia e drurëve pyjorë

Në shkollën 9-vjeçare "Zenel Bastari" në Bastar të Mesëm, e cila ndodhet brenda Parkut Kombëtar "Mali i Dajtit", u zhvillua një aktivitet ndërgjegjësues me pjesëmarrjen e disa nxënësve të klasës së tetë dhe të nëntë. Gjatë aktivitetit, nxënësit mësuuan mbi rëndësinë e drurëve pyjorë në jetën tonë dhe ndikimin e tyre pozitiv si për njerëzit ashtu edhe për kafshët. Si pjesë e angazhimit të tyre, ata krijuan një poster ndërgjegjësues mbi mbrojtjen e natyrës dhe më pas, me përkushtim, morën pjesë në mbjelljen e disa fidanëve në ambientet e shkollës. Përmes kësaj nisme, nxënësit jo vetëm që u edukuan mbi kujdesin për natyrën, por edhe kontribuan konkretisht duke lënë një gjurmë të gjelbër për brezat e ardhshëm.

21 shkurt 2025, aksion pastrimi

Specialistët e Administratës së Zonave të Mbrojtura në Tiranë organizuan një aktivitet pastrimi në shkollën 9-vjeçare "Tufinë" me nxënësit e klasës së gjashtë. Aktiviteti kishte për qëllim pastrimin e ambjenteteve përreth shkollës dhe ndërgjegjësimin e nxënësve për rëndësinë e ruajtjes së një mjedisi të pastër dhe të shëndetshëm. Nxënësit, të paisur me qese dhe doreza, dhanë një shembull të pozitiv duke kontribuar në pastrimin e hapësirave përreth shkollës. Ky aktivitet i ndihmoi nxënësit të kuptojnë përgjegjësinë që kanë ndaj natyrës dhe mjedisit, duke përçarur mesazhin se çdo individ mund të japë një kontribut, për të ruajtur një ambient më të pastër dhe më të shëndetshëm.



17 dhjetor 2024, aktivitet krijues

Nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Hasan Tahsin” Tiranë, mirëpritën specialistët e AdZM Tiranë për të realizuar një orë mjedisore dedikuar krijimtarisë me anë të materialeve natyrore. Aktiviteti u fokusua në krijimin e një peme festive ku nxënësit përdorën degë të thata, boçe pishe dhe bimën e njohur si ashja, e cila është simbol i krishtlindjeve. Gjithashtu nxënësit krijuan kartolina unike me plot ngjyra, duke përcjell frymën festive dhe rëndësinë e ruajtjes së mjedisit.

20 dhjetor 2024, njohja me pishat dhe bredhat

Një orë mjedisore u zhvillua në ambientet e kubit InNature nga specialistët e AdZM Tiranë me temë “Krijimi dhe Dekorimi i Bredhave të Festivë”. Në këtë aktivitet morën pjesë fëmijë të grupmoshave 7-11 vjeç. Fëmijët u njohën me llojet e bredhave në Shqipëri, karakteristikat e tyre dhe rëndësinë për mjedisin. Aktiviteti solli një mundësi për fëmijët të shprehin krijimtarinë e tyre dhe të kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit, duke i ndihmuar ata të kuptojnë si mund të përdoren materialet natyrore për të krijuar produkte të bukura. Bredhat e dekoruara dhe dekorimet shumëngjyrëshe që ata krijuan ishin një dhuratë festive për veten dhe një mësim mbi rëndësinë e natyrës dhe mbrojtjen e mjedisit.

“EDUKIMI MJEDISOR”, ELBASAN



4 shkurt 2025, Vlera natyrore

Një orë mjedisore u realizua në shkollën e Mesme të Bashkuar “Isak Alla”, ku specialistët e Administratës së Zonave të Mbrojtura të Elbasanit prezantuan vlerat natyrore të Parkut Kombëtar “Shebenik”. Nxënësit u njohën me florën dhe faunën e parkut, duke përfshirë llojet endemike dhe të tjera. Ora u zhvillua në formën e një bashkëbisedimi interaktiv, ku nxënësit morën pjesë duke bërë pyetje dhe duke shprehur interes për temën.

11 shkurt 2025, Studim habitati në Parkun Kombëtar “Shebenik”

Studimi i habitatit të Parkut Kombëtar “Shebenik” ishte tema e orës mjedisore realizuar nga specialistët e AdZM Elbasan me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Isuf Gjura”. Gjatë këtij aktiviteti, nxënësit u njohën me bimët mjekësore dhe vlerat natyrore të parkut. Aktiviteti synonte promovimin e njohurive mbi biodiversitetin dhe dashurinë për natyrën.

12 shkurt 2025, aksion pastrimi

Edukimi dhe ndërgjegjësimi i të rinjve për mbrojtjen e natyrës është një prioritet i specialistëve të Administratës së Zonave të Mbrojtura (AdZM) Elbasan. Në këtë kuadër, u zhvillua një aksion pastrimi në ambientet e shkollës 9-vjeçare Letëm dhe në zonën përreth saj. Ky aktivitet kishte si qëllim sensibilizimin e nxënësve dhe përçimin e mesazhit: “Ambient i pastër, jetë e shëndetshme!”. Nxënësit, të shoqëruar nga mësuesi, pastruan shkollën dhe mjedisin përreth, duke promovuar rëndësinë e ruajtjes së mjedisit dhe kujdesit për natyrën.

Parku Kombëtar Shebenik

vlera natyrore

habitate

aktivitet pastrimi

bashkëbisedim

18 shkurt 2025, orë mjedisore

Në shkollën 9-vjeçare "Shaban Leka", specialistët e AdZM Elbasan zhvilluan një orë mjedisore mbi vlerat e Parkut Kombëtar "Shebenik". Gjatë kësaj ore edukuese, nxënësit u njohën me vlerat e parkut, bimët mjekësore që rriten në këtë park, si dhe me rëndësinë e tij në ruajtjen e biodiversitetit. Aktiviteti kishte për qëllim informimin e nxënësve për pasuritë natyrore të zonës dhe sensibilizimin e tyre për mbrojtjen e natyrës

20 shkurt 2025, aksion pastrimi

Aksionet e pastrimit me nxënësit janë shumë të rëndësishme, pasi ato ofrojnë mundësi për të angazhuar individët dhe komunitetet në aktivitete që promovojnë veprime të drejta ndaj natyrës, duke i mësuar ata për përgjegjësinë dhe rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit. Në këtë kuadër, specialistët e AdZM Elbasan realizuan një aktivitet pastrimi në bashkëpunim me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Daut Gurra". Aktiviteti u zhvillua në ambientet e shkollës dhe zonën përreth saj, ku nxënësit, të pajisur me mjete pastrimi, kontribuan për të mbajtur mjedisin të pastër.

25 shkurt 2025, orë mjedisore

Vlerat e Parkut Kombëtar Shebenik janë shumë të rëndësishme për ruajtjen e biodiversitetit dhe pasurive natyrore të vendit. Ky park, me florën dhe faunën e tij të pasur, luan një rol të rëndësishëm në ruajtjen e ekosistemeve dhe mbrojtjen e llojeve të ndryshme të bimëve dhe kafshëve. Për të promovuar dhe përçuar këto vlera, specialistët e AdZM Elbasan zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare Fushë Studen. Gjatë kësaj ore edukative, nxënësit u njohën me bimët mjekësore që ndodhen në këtë park dhe rëndësinë e ruajtjes së tyre. Aktivitetet kishin si qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për pasuritë natyrore dhe nxitjen e dashurisë për natyrën tek brezat e rinj.



2 shkurt 2025, Dita Botërore e Ligatinave

"Ruajmë ligatinat, ndërtojmë të ardhmen! Vlerëso, Mbro, Frymëzohu!"

Kjo thirrje është një apel për të investuar në mënyrë të zgjuar për rehabilitimin dhe mbrojtjen e ligatinave, duke shmangur degradimin e tyre. Specialistët e AdZM Fier zhvilluan një takim të hapur në formë bashkëbisedimi me studentët e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës, ku u diskutua rëndësia e ligatinave në ekosistemet e Shqipërisë dhe rolin e tyre për biodiversitetin. Në përfundim të aktivitetit, për të kontribuar në ruajtjen e mjedisit, u mbollën 200 fidanë pishë, duke shtuar kështu sipërfaqen e gjelbër të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta. Ky aktivitet kishte për qëllim jo vetëm përmirësimin e mjedisit, por gjithashtu promovimin e ruajtjes së natyrës dhe frymëzimin e brezave të rinj për mbrojtjen e pasurive natyrore të Shqipërisë.

6 shkurt 2025, edukim mjedisor

Në kuadër të orëve mjedisore, nxënësit e Shkollës 9-vjeçare "Foto Puka" në Lushnje morën pjesë në një aktivitet të hapur të organizuar nga specialistët e AdZM Fier në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta. Ky aktivitet kishte si qëllim angazhimin e nxënësve në njohjen dhe vlerësimin e pasurive natyrore të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta, si dhe theksimin e rëndësisë së ruajtjes së mjedisit për brezat e ardhshëm. Ata u njohën me vlerat natyrore të Parkut në Qendrën e Vizitorëve, ku specialistët e AdZM Fier prezantuan informacion të detajuar mbi florën dhe faunën e pasur të parkut. Pas kësaj, nxënësit zhvilluan ecje dhe lojëra në natyrë, aktivitete që ndihmuan në përfundimin e njohurive të tyre.

7 shkurt 2025, flora dhe fauna në parkun PK "Divjakë-Karavasta"

Specialistët e AdZM Fier realizuan një orë mjedisore me nxënësit e Tirana International School, me qëllim njohjen me ekosistemet natyrore të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta. Gjatë kësaj ore, nxënësit morën informacion mbi florën dhe faunën e parkut, duke u fokusuar në rëndësinë e tij për biodiversitetin dhe ruajtjen e natyrës. Aktiviteti përfshiu gjithashtu vëzhgimin e shpendëve në zonat ligatinore të parkut, duke ofruar mundësi për njohuri praktike mbi rolin e këtyre ekosistemeve në mbrojtjen e mjedisit.

“EDUKIMI MJEDISOR”, GJIROKASTËR



12 shkurt 2025, monitorimi i faunës

AdZM Gjirokastrë zhvilloi një orë mjedisore me nxënësit e shkollës “Nonda Bulka” në Përmet, me temën “Monitorimi i faunës, gjurmëve, paisjet me të cilat monitorojmë”. Gjatë aktivitetit, nxënësit u njohën me rëndësinë e monitorimit të faunës dhe studimin e sjelljes së kafshëve, si dhe metodat dhe paisjet e përdorura për këtë qëllim. Disa nga paisjet që u demonstruan përfshinin kamerat e kurthit, GPS, dylbi etj., të cilat ndihmojnë në mbledhjen e të dhënave të sakta për studimin dhe mbrojtjen e ekosistemeve. Qëllimi i aktivitetit ishte ndërgjegjësimi i nxënësve mbi rëndësinë e mbrojtjes së biodiversitetit dhe përdorimin e teknologjisë për të studiuar dhe ruajtur natyrën.

14 shkurt 2025, gjurmët e kafshëve të egra

Kafshët e egra kanë një rëndësi të veçantë në zonat e mbrojtura, pasi ato kontribuojnë në ruajtjen e ekuilibrit natyror dhe qëndrueshmërisë së ekosistemeve. Në kuadër të ndërgjegjësimi mjedisor tek brezat e vegjël, specialistët e AdZM Gjirokastrë zhvilluan një orë mjedisore në kopshtin “Kamber Bënja” në Këlcyrë, me temën “Gjurmët e kafshëve të egra”. Fëmijët patën mundësi të mësojnë mbi rëndësinë e këtyre gjurmëve si një mjet për identifikimin dhe monitorimin e kafshëve të egra, duke theksuar vlerën e tyre për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit në vendin tonë.

27 shkurt 2025, rëndësia e riciklimit

Riciklimi është një proces thelbësor në menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve dhe në ruajtjen e burimeve natyrore. Në shkollën “Koço Shukallari”, specialistët e ADZM Gjirokastrë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit, ku u trajtuan tema të rëndësishme si: reduktimi i mbetjeve, ruajtja e burimeve natyrore, ulja e ndotjes, kursimi i energjisë, zhvillimi i industrisë së riciklimit dhe përmirësimi i cilësisë së jetës. Aktiviteti synoi të risë ndërgjegjësimin e nxënësve për rëndësinë e riciklimit dhe rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit.

Monitorimi i faunës

kafshë të egra

riciklimi

zona të mbrojtura

“EDUKIMI MJEDISOR”, KORÇË



19 shkurt 2025, njohja me flamingot

Flamingot janë shpendë elegantë me këmbë të gjata dhe ngjyrë rozë tërheqëse, që jetojnë kryesisht në zona të lagështa dhe të mbrojtura. Specialistët e AdZM Korçë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasave të 4-ta të shkollës “Sotir Gurra”, ku i njohën ata me jetën, sjelljen dhe rëndësinë e mbrojtjes së flamingove. Gjatë këtij aktiviteti edukues, nxënësit shprehën aftësitë e tyre krijuese duke realizuar figura të flamingove me karton, ngjyra dhe elementë dekorues, duke kombinuar të mësuarin me argëtimin. Aktiviteti përçoi mesazhin se njohja dhe mbrojtja e shpendëve të egër është një hap i rëndësishëm drejt ruajtjes së biodiversitetit në zonat e mbrojtura.

21 shkurt 2025, shëtitje në natyrë

Specialistët e AdZM Korçë organizuan një shëtitje edukuese në natyrë me nxënësit e shkollës “Petro Nini Luarasi” në Ersekë. Gjatë aktivitetit, nxënësit u njohën nga afër me vlerat natyrore të zonave të mbrojtura dhe me rëndësinë ekologjike të zonave ligatinore si habitate për shpendët ujorë. Në këtë aktivitet mori pjesë edhe drejtori i turizmit të rrethit Kolonjë, i cili theksoi rëndësinë e ndërthurjes së turizmit të qëndrueshëm me ruajtjen e natyrës. Mesazhi i përçuar gjatë aktivitetit ishte rëndësia e mbrojtjes së këtyre ekosistemeve ligatinore dhe angazhimi i të rinjve në ruajtjen e biodiversitetit përmes edukimit dhe përvojave në terren.

25 shkurt 2025, fole prej druri

Në kuadër të edukimit mjedisor dhe ndërgjegjësimit për ruajtjen e natyrës, nxënësit e shkollës “Profesionale Teknike” në Korçë, u angazhuan në një aktivitet krijues me temën “Të krijojmë fole prej druri”. Fillimisht ata u njohën me rëndësinë e zonave të mbrojtura të rrethit, përfshirë Parkun Kombëtar të Prespës, dhe më pas ndërtuan foleza druri për zogjtë, duke përdorur materiale të qëndrueshme dhe praktika të thjeshta ndërtimi. Folezat e realizuara do të vendosen në habitatet natyrore të Parkut të Prespës, duke kontribuar në mbrojtjen dhe përkrahjen e faunës së egër, veçanërisht të shpendëve të zonës.



2 shkurt 2025, Dita Botërore e Ligatinave

Ditën Botërore të Ligatinave, specialistët e AdZM Vlorë e kremtuan së bashku me nxënësit e shkollës jopublike “Drita e Dijes” në Vlorë, ku u zhvillua një orë mjedisore me fokus mbi rëndësinë e ligatinave dhe praktikat e monitorimit që realizohen në zonat e mbrojtura. Nxënësit u njohën me rolin kyç që kanë ligatinat në ruajtjen e biodiversitetit, veçanërisht për shpendët, si dhe me nevojën për mbrojtjen e tyre nga ndotjet dhe ndikimet njerëzore. Aktiviteti synoi të nxisë ndërgjegjësimin dhe dashurinë për natyrën që në moshë të hershme.

orë mjedisore orë mjedisore

ditë botërore